

STATUT

I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“IK FURNITURE sh.p.k”

(Hartuar ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”).

NENI 1 Emertimi dhe Forma e Shoqërisë

1.1 “IK FURNITURE” Sh.p.k themelohet në formën e një shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe aktiviteti i kesaj shoqerie do te rregullohet nga ky Statut dhe nga ligji “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

1.2. Emërtimi “IK FURNITURE” Sh.p.k dhe emri i administratorit do të figurojnë në të gjitha aktet ose dokumentet e nxjerra nga shoqëria dhe që u drejtohen të tretëve.

1.3. Shoqeria “IK FURNITURE” Sh.p.k e fiton personalitetin e saj juridik nga dita e rregjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit.

NENI 2 Dokumentat Rregullues

2.1. Dokumenti kryesor mbi të cilin bazohet aktiviteti i Shoqërisë “IK FURNITURE” Sh.p.k është Statuti i saj. Me ane te ketij Statuti dhe ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe me legjislacionin shqiptar, rregullohet pozita juridike e Ortakeve dhe punonjesve te Shoqërise, organizimi dhe objekti i veprimtarise se Shoqërise dhe çështjet e tjera me rëndësi për aktivitetin e saj.

2.2 Per çështjet qe nuk zgjidhen nga Statuti, Asambleja e Ortakëve mund të miratojë një Rregullore të Veçantë.

2.3. Statuti dhe Rregullorja e Veçantë janë dokumenta të hapura për ndryshime dhe përmirësimë që zhvillimet i bëjnë të nevojshme.

NENI 3 Ortaket

2.1 Ortaket e shoqise “IK FURNITURE” Sh.p.k ”jane

BEHAR NAZERAJ person me shtetesi shqipetare , i datelindjes 17/03/1977, mbajtes i kartes se identitetit me nr ID H 70317211T, **ISMAILIN KRASHI** person me shtetesi shqipetare i datelindjes 26/04/1991 mbajtes i kartes se identitetit me nr ID J10426079U , dhe **ILIR KACA** person me shtetesi shqipetare i datelindjes 12/05/1985 mbajtes i kartes se identitetit me nr I 50512021 S.



NENI4

Selia

4.1. Shoqeria " I,K FURNITURE " Sh.p.k e ka seline e saj ne adresen: Peze Helmas, zona kadastrale nr 2953, nr pasurie 245, vol 8 fq71, Peze Helmas , Tirane

Shoqeria vepron si person juridik shqiptar dhe si e tille mund te kryeje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ose jashtë saj, nepermjet filialeve, degeve, zyrave te perfaqesimit ose agjensite e saj, te cilat jane krijuar me vendim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

4.2. Asambleja e Ortakeve mund te transferoje Seline e Shoqerise brenda teritorit te Shqiperise.

NENI 5

Kohezgjatja

5.1. Shoqeria do te kryeje aktivitetin e saj per nje periudhe kohe te pacaktuar.

NENI 6
Administratori

6.1. Administrator i shoqerise dote jete **ISMAILIN KRASHI** me nr ID J10426079U. Mandati i administratorit ne detyre do te jete per nje afat 5 vjecar me te drejte riemerimi.

NENI 7
Objekti i veprimtarise se Shoqerise


7.1. Shoqeria "IK FURNITURE " Sh.P.K ushtron veprimtarine e saj me qellim realizimin e fitimit, duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe rentabilitetit, sipas rregullave te parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

7.2. Veprimtaria e Shoqerise "I.K FURNITURE " Sh.p.k, do te kete per objekt

> SHERBIME MOBILERIE , SHITJE ME SHUMICE DHE PAKICE

7.3 Shoqeria "I.K FURNITURE " Sh.p.k mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjeter qe eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe qe siguron fitime dhe te ardhura te ligjshme brenda kufijve te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi, mund te kryeje cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e saj. Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqerive te tjera brenda dhe jashtë vendit.

7.4. Shoqeria, mund te lidhe marreveshje tregtare apo bashkepunimi me shoqeri apo sipermarrje te tjera, si dhe te kryeje cdo veprim tregtar qe konsiderohet i nevojshem me qellim arritjen e objektit te veprimtarise se saj.



7.5. Shoqëria mund të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj dhe emërtimin vetëm me vendim të Administratorit të saj. Vendimi i Administratorit administrohet në përputhje me legjislacionin dhe rregistrohet në QKB-se dhe në Organet Tatimore.

7.6. Shoqëria "IK FURNITURE" Sh.p.k do te ushtroje veprimtarine per ato aktivitete qe kerkojne marrjen e licensave dhe lejeve perkatese vetem pas marrjes se tyre nga organet dhe strukturat e caktuara nga ligji.

Shoqëria "IK FURNITURE" Sh.p.k do te ushtroje veprimtarine në përbushje të objektit të veprimtarisë së saj, duke zbatuar të gjithë ligjet dhe aktet nënligjore rregullues në lidhje me liçensimin, kushtet, procedurat dhe afatet e kërkuar.

Gjatë kohëzgjatjes së aktivitetit të saj Shoqëria "IK FURNITURE" Sh.p.k zbaton standartet më të larta të etikës profesionale dhe zbatimit të ligjshmërisë.

II. KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

NENI 8 Kapitali themeltar

8.1. Kapitali themeltar i shoqerise "IK FURNITURE" Sh.p.k eshte 100.000 (njeqindemije) Leke.
8.2. Kapitali i shoqerise eshte 100.000 (njeqindemije) Leke dhe eshte i ndare ne 3 (tre) kuota .

- 1.Ortaku BEHAR NAZERAJ zoteron 34 % te kapitalit themeltar (1 kuot)
- 2.Ortaku zoteron ISMAILIN KRASHI 33 % te kapitalit themeltar (1 kuot)
3. Ortaku zotron ILIR KACA 33% te kapitalit themeltar (1 kuot)

8.3. Çdo pjese e kapitalit themeltar i jep te drejten e nje vote zoteruesit te saj.

8.4. Ortaku i Shoqerise "IK FURNITURE" Sh.p.k per gjigjet per detyrimet ndaj te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne formimin e Kapitalit Themeltar të Shoqerise.

NENI 9 Transferimi

9.1. Pjeset e kapitalit mund të transferohen lirisht ndërmjet ortakeve.

9.2. Transferimi i pjeseve te kapitalit tek persona te trete qe nuk bejne pjese ne Shoqeri iu nenshtrohet ketyre rregullave:

- a) Transferuesi ose Ortaku transferues, duhet të njoftoje Ortaket e tjere për numrin e pjeseve qe do te transferohen, çmimin e shitjes ne rast shitjeje, si dhe emrin, mbiemrin dhe adresen e personit te cilit mendon t'i transferohen pjeset.
- b) Transferimi duhet te miratohet nga Ortaket e tjere brenda 3 muajve nga data e njoftimit. Ne rast se Ortaket nuk e kane bere te ditur vendimin e tyre brenda afatit 3 mujor miratimi quhet i dhene.
- c) Ne rast se Ortaket refuzojne transferimin, brenda 3 muajve nga data e refuzimit, atëherë ata duhet t'i blejne pjeset e propozuara per transferim. Çmimi i shitjes eshte vlera kontabel e pjeseve.



d) Ne rast se Ortaku nuk eshte i interesuar te bleje pjeset, atehere Ortakët e Shoqërisë do të bien dakort nese:

1. pjeset do ti shiten personit te propozuar nga Ortaku transferues me cmimin e rene dakort midis tyre;
2. pjeset do ti shiten nje personi tjeter te trete me çmimin e rene dakort me kete person , por jo me pak se vlera kontabel e tyre;
3. pjeset do te blihen nga Shoqeria per tu annulluar, ne kuadrin e nje zvogelimi kapitali, ne perputhje me ligjin "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

9.3. Pjesët e Kapitalit Themeltar janë lirisht të transferueshme ne rruge trashegimie, ne rast ndarjeje pasurie ndermjet bashkeshorteve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

9.4. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë që bashkëshorti, trashëgimtari, paraardhësi ose pasardhësi të bëhen ortakë, nëpërmjet transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar, vetëm pasi të jetë miratuar nga Asambleja sipas kushteve që caktojnë Ortakët. Kushtet për ortakun e ri nuk mund të janë më pak të favorshme se ato të caktuara për të tretët për rastet e transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar, përndryshe Vendimi i Asamblesë është i pavlefshëm.

9.5. Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar, ne çdo rast, duhet te vertetohet me akt notarial.

NENI 10 Zmadhimi i Kapitalit

10.1. Kapitali themeltar mund te zmadhohet me vendim te ortakut , ne perputhje me ligjin "Per tregtaret dhe shoqerite tregetare", ne baze te raportit te Administratorit te Shoqerise.

10.2. Zmadhimi i kapitalit mund te kryhet me ane te kontributeve te reja ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave dhe fitimit si pjesë të Kapitalit Themeltar.

10.3. Ne rast zmadhimi te kapitalit me ane te kontributeve në para, te gjitha pjeset e reja të Kapitalit duhet te nenshkruhen dhe te shlyhen teresisht nga Ortaku. Ato duhet te depozitoohen nga nenshkruesit në Bankë per llogari te Shoqerise "**IK FURNITURE**" Sh.p.k.

NENI 11 Zvogelimi

11.1. Zvogelimi i kapitalit mund te kryhet me vendim te ortakut, ne perputhje me ligjin "Per tregtaret dhe shoqerite tregetare".

11.2. Zvogelimi i prek Ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe ata zotërojne.

III. MARRJA E VENDIMEVE , ADMINISTRIMI, DHE KONTROLLI I SHOQERISE

NENI 12 Organet drejtuese



12.1. Organet drejtiese të Shoqerisë "IK FURNITURE " Sh.p.k. janë:

- a) Asambleja e Ortakëve në të cilën marrin pjesë Ortaku i Shoqërisë ose përfaqësuesit e tyre të pajisur më prokurë të veçantë; dhe
- b) Administratori.

NENI 13

Asambleja e Ortakeve dhe konsultimet ndermjet Ortakeve

13.1. Vendimet merren nga Asambleja e Ortakeve. Asambleja e Ortakeve merr vendime per ceshtjet qe ligji apo ky statut ia rezervon ketij organi, si dhe per ceshtjet per te cilat, Administratori kerkon mendimin apo miratimin e Asamblesë së Ortakëve.

13.2. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve merren me shkrim dhe regjistrohen ne nje regjister te posacem te mbajtur prane selise se Shoqerise "IK FURNITURE " Sh.p.k.

13.3. Perveç rasteve të miratimit të llogarive vjetore si dhe ndryshimeve të Statutit, Asambleja mund te marre vendime edhe me ane te konsultimit me shkrim te ortakeve. Administratori ka të drejtën e zgjedhjes së formës së marrjes së vendimit ndërmjet mbledhjes së Asamblesë ose konsultimit me shkrim.

13.4. Çdo mbledhje e Asamblesë e thirrur në mënyrë të parregullt, si dhe çdo konsultim me shkrim i kryer në mënyrë të parregullt, mund të anulohet. Megjithatë anulimi nuk ka vlerë, në rast se të gjithë ortakët kanë qenë të pranishëm ose të përfaqësuar si dhe kanë miratuar projektvendimin e propozuar.

NENI 14

Marrja e vendimeve

14.1. Çdo ortak, pavarësisht nga numri i kuotave të kapitalit që zoteron, ka te drejte te marrë pjesë ne mbledhjet dhe ne vendimet e asamblese dhe disponon nje numer votash te barabarte me kuotat e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

14.2. Kur Asambleja e Ortakëve është thirrur për të marrë një vendim për një marrëveshje midis Shoqërisë dhe Ortakut, ky i fundit nuk mund të marrë pjesë në votim dhe vendimi merret nga Ortaku ose Ortakët e tjerë të Shoqërisë.

14.3. Çdo ortak ka te drejte te përfaqesohet ne keto mbledhje nga nje ortak tjeter ose nga nje mandatmbajtes i cili mund te votoje ne emer te atij qe përfaqeson. Mandati i përfaqësimit nuk mund të jetë i përhershëm, por jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë. Mandati i dhënë për një mbledhje të Asamblesë është i vlefshëm për mbledhjet e tjera, që thirren si vazhdim i së parës dhe me të njëjtin rend dite.

14.4. Në mbledhjet e Asamblesë ose në konsultimet me shkrim vendimet merren nga një ose disa ortakë që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar. Në rast se nuk sigurohet kjo shumicë, ortakët konsultohen për herë të dytë dhe vendimet merren me shumicën e votave të dhëna, pavarësisht nga përqindja e kapitalit që ato përfaqësojnë.

Neni 15



Zhvillimi i mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve

15.1. Asambleja e Ortakëve i zhvillon mbledhjet ne seline e Shoqerise ose ne nje vend tjeter te caktuar nga vete Ortakët.

15.2. Asambleja mblidhet ne menyre te rregullt jo me pak se dy herë në vit, dhe njëra prej mbledhjeve zhvillohet brenda nje afati prej 6 muajsh nga dita e mbylljes se viti financiar. Asambleja mund te thirret ne çdo kohe me kerkesen e:

a. nje apo disa ortakeve qe perfaqesojne jo më pak se 5% te kuotave te kapitalit themeltar,

b.ekspertit kontabel te autorizuar. Përpara se të thérresë Asamblenë, eksperti kontabël i autorizuar njofton administratorin me letër rekomande.;

c. te administratorit. Në qoftë se janë disa administratorë, e drejta e thirrjes së Asamblesë mund t'i besohet ose secilit administrator ose të gjithë administratorëve që të veprojnë bashkarisht.;

d. te likuiduesit.

15.3. Administratori iu njofton me leter rekomande, te gjithe ortakeve mbledhjen e Asamblese, te pakten 15 dite perpara mbledhjes. Lajmerimi permban daten, adresen dhe rendin e dites se mbledhjes. Duke filluar nga data e komunikimit, çdo ortak ka të drejtë të paraqesë pyetje me shkrim, të cilave Administratori duhet t'u përgjigjet në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve.

15.4. Kur Administratori ose eksperti kontabël i autorizuar kanë refuzuar të mbledhin Asamblenë, secili nga Ortakët mund t'i drejtohet Gjykatës për caktimin e një mandatmbajtësi të ngarkuar për thirrjen e Asamblesë së Ortakëve.

15.5. Asambleja drejtohet nga Administratori ose nga Ortaku që zotëron ose përfaqëson numrin më të madh të pjesëve të Kapitalit. Nëqoftëse dy Ortakë zotërojnë të njëtin numër pjesësh, drejtimi i mbledhjes bëhet nga Ortaku më i moshuar. Kompetencat, te drejtat dhe detyrimet e Kryetarit të Asamblesë ndaj Shoqerise, rregullohen ne aktin e emerimit të tij.

15.6. Kryetari i Asamblese emeron nje person fizik, ortak ose jo, ne postin e sekretarit. Sekretari mban proces-verbalin e mbledhjes, i cili firmoset nga te gjithe ortaket e pranishem ne mbledhje.

15.7. Proçes-verbal i mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve do te permboje sa me poshte vijon:

a. Datën dhe vedin e zhvillimit të mbledhjes;

b. Menyren e njoftimit;

c. Kryetarin e Asamblesë dhe Sekretarin;

d. Rendin e dites;

e. Numrin dhe emrat e pjesëmarrësve;

f. Raportet dhe dokumentet qe jane paraqitur ne mbledhje;

g. Permbledhjen e diskutimeve të zhvilluara;

h. Numrin e votave bazuar në pjesët e Kapitalit Themeltar;

i. Tekstet e projekt-vendimeve te votuar, ata te miratuar dhe ata te hedhur poshte nga Ortakët.

15.8. Votimi kryhet i veçantë për çdo projektvendim dhe nëqoftëse një projektvendim përmban shumë çështje që secila mund të kërkojë një votim të veçantë, atëherë çdo ortak mund të kërkojë ndarjen e projektvendimit në disa projektvendime të veçantë.



15.9. Votimi eshte ne parim i hapur, por mënyra e votimit përcaktohet në marrëveshje ndërmjet ortakëve. Me kerkese te nje ose disa ortakeve qe perfaqesojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit, votimi zhvillohet i fshehtë.

15.10. Te gjitha vendimet e shoqerise regjistrohen ne nje liber te veçante qe mbahet ne seline e Shoqerise, i cili duhet të jetë i numërtuar dhe i vulosur.

Neni 16
Kompetencat e Asamblesë së Ortakëve

16.1. Jane ne kompetencen ekskluzive te Asamblese së Ortakëve marrja e vendimeve per sa i perket:

- a. ndryshimit të Statutit;
- b. riorganizimi i shoqerise, ndarja, bashkimi, likujdimi;
- c. linjat baze per zhvillimin e aktivitetit te Shoqerise;
- d. zmadhimi, zvogelimi i kapitalit, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek të tretët, si dhe blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar nga vete shoqeria me qellim anullimin e tyre;
- e. miratimi i llogarive, raportit vjetor, inventaret, rapporti i eksperteve kontabel te autorizuar;
- f. hapja e filialeve, degeve apo zyrave te reja;
- g. marrja hua, lenja peng apo çdo barre tjeter siguruese;
- h. hapja e nje aktiviteti te ri ekonomik;
- i. emerimi dhe shkarkimi i Kryetarit te Asamblese;
- j. emerimi dhe shkarkimi i Administratorit;
- k. emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar;
- l. blerja e pasurive te paluajtshme;
- m. blerja e aksioneve, certifikatave apo titujeve te shoqerive te tjera tregtare, apo e çdo lloj instrumenti financiar;
- n. Prishjen e shoqerise ne rast se humbjet jane me te medha se gjysma e kapitalit;
- o. Shnderimin e Shoqerise në një formë tjetër;
- p. si dhe te gjitha kompetencat e tjera qe ligji dhe/ose ky Statut i jepin shprehimisht Asamblese.

NENI 17
Administratori i Shoqërisë

17.1. Shoqeria administrohet nga 1(nje) Administrator, person fizike qe mund te jete ose jo ortak te Shoqerise.

Administrator i shoqerise do te jete Z. **ISMAILIN KRASHI** me nr ID J10426079U.

17.2. Administratori është i detyruar të drejtojë Shoqerinë "**IK FURNITURE**" Sh.p.k. në përputhje me ligjin « Për tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare », këtë Statut, vendimet e Asamblesë së Ortakëve dhe sipas dispozitave të tjera ligjore në fuqi.

17.3. Ne rastet kur Administratori është Ortak i Shoqërisë "**IK FURNITURE**" Sh.p.k. në baze te nenit 5 te Kodit Shqiptar te Punes, detyra e Administratorit nuk do të regullohet nga kontrata e punes.



17.4. Administratori i Shoqerise "I.K FURNITURE" Sh.p.k nje here ne tre muaj, duhet t'i paraqese Asamblese se Ortakeve, per kontroll dhe verifikim, raportin mbi administrimin e Shoqerise.

17.5. Administratori i Shoqerise "I.K FURNITURE" Sh.p.k brenda tre muajve nga mbyllja e vitit finanziar te Shoqerise, duhet t'i paraqese Asamblese se Ortakeve per kontroll dhe verifikim, raportin finanziar vjetor dhe bilancin e Shoqerise.

17.6. Administratori percatit gjithashtu edhe raportin e administrimit per gjendjen e shoqerise gjate vitit finanziar te kaluar, ndryshimet e parashikuara per te ardhmen, ngjarjet me te rendesishme qe kane ndodhur gjate periudhes nga data e mbylljes se vitit finanziar deri ne daten e hartimit te ketij reporti

17.7. Administratori duhet t'i transmetoje Asamblese se Ortakeve te gjithe korrespondencen e rmbajtur me Ekspertet Kontabel te Autorizuar te Shoqerise.

NENI 18
Emerimi dhe shkarkimi i Administratorit

18.1. Administratori i Shoqerise emerohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakeve, si dhe do te qendroje ne detyre per nje periudhe 5 (pese)vjecare

18.2. Kohezgjatja e mandatit te Administratorit mund te percaktohet nga Ortaket sa here qe behet emerimi i Administratorit dhe do te parashikohet ne aktin e emerimit. Ne mbarim te afatit te parashikuari, Administratori mund te riemerohet. Ne mungese te parashikimeve kohore ne aktin e emerimit, Administratori do te ushtroje detyrat e tij per te gjithe periudhen e aktivitetit te Shoqerise

18.3. Administratori i Shoqerise "I.K FURNITURE" Sh.p.k mund te shkarkohet para perfundimit te mandatit ne rastet e meposhtme

- a. Nese eshte shpallur fajtor me vendim te formes se prere te gjykates per kryerjen e nje vepre penale qe ka lidhje me veprimtarine ekonomiko-fmanciare;
- b Nese vertetohet se ka shperdoruar fondet e Shoqerise
- c. Ne rast se me vendim te gjykates kompetente i eshte kuftuar apo hequr zotesia per te vepruar,
- d. Nese eshte ndaluar per te administruar dhe drejtuar shoqerite;
- e. Ne cdo rast tjeter qe pengon ne menyre te zgjatur Administratorin te kryeje funksionet e tij,
- f. Si dhe per cdo arsyte drejtue qe vleresohej nga Asambleja e Ortakeve

18.5 Konsiderohet arsyte e drekte per shkarkimin e Administratorit:

- a. refuzimi i vazhdueshem i Administratorit per t'u nenshtruar rregullave te ligjit dhe dispozitave te Statutit lidhur me miratimin vjetor te llogarive dhe me te drejten e ortakeve per t'u informuar;
- b. administnmi i keq finanziar f Shoqerise "I.K FURNITURE" Sh.p.k
- c. pavaresisht nga gabimet e Administratorit, do te konsiderohet arsyte e drekte per shkarkimin e Administratorit fakti i humbjes se besimit dhe marredheniet jo te mira me Ortaket, bankieret dhe Administraten publike;



d. Administratori ka ndjekur një politikë personale në administrimin e Shoqërisë dhe nuk ka pranuar sugjerimet e vazhdueshme të Ortakëve për mirëadministrimin e Shoqërisë.

18.6. Me kërkesë Ortakut të Shoqërisë "IK FURNITURE" Sh.p.k. Administratori mund të shkarkohet nga Gjykata për shkelje të ligjit ose të Statutit.

18.7. Efektet e Vendimit për shkarkimin e Administratorit fillojnë nga data e marrjes së tij dhe vendimi nuk mund të ketë fuqi prapavepruese.

NENI 19 **Dorëheqja e Administratorit**

19.1. Administratori qoftë Ortak ose jo, mundet në çdo kohë të japë dorëheqjen, por nëse dorëheqja bëhet pa arsyё tё drejtё, Shoqëria "IK FURNITURE" Sh.p.k mund tё kérkojë dëmshpërblim financier në masën që ёshtë dëmtuar nga kjo dorëheqje.

19.2. Administratori që kérkon tё japë dorëheqjen duhet tё njoftojë me letër rekomande me kthim përgjigje Administratorët e tjerë si dhe tё gjithë Ortakët.

19.3. Njoftimi i dorëheqjes e bëن dorëheqjen përfundimtare dhe Administratori nuk mund tё rimarrë funksionet e tij.

NENI 20 **Kompetencat e Administratorit**


20.1. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne emer dhe per interes te Shoqerise "IK FURNITURE" Sh.p.k me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji dhe/ose ky Statut i jatin shprehimisht Asamblese së Ortakëve.

20.2. Administratori ka te drejte te perfaqesoje Shoqerine para te treteve dhe te gjitha vendimet manaxheriale te Shoqerise "IK FURNITURE" Sh.p.k duhet te nenshkruhen te pakten nga Administratori.

20.3. Asambleja e Ortakëve mund t'i japë autorizim paraprak Administratorit për kryerjen e operacioneve tё caktuara ose lidhjen e kontratave tё cilat konsiderohen tepër tё rëndësishme për Shoqërinë.

20.4. Megjithatë, pa përjashtuar masa tё tjera më tё detajuara dhe rregullore tё brendshme tё Shoqërisë, veprimet dhe kompetencat e mëposhtme Administratori mund t'i kryejë vetëm me autorizim paraprak tё Asamblesë së Ortakëve:

- a) përcaktimi dhe ndryshimi i programit tё veprimitarisë afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë tё Shoqërisë "IK FURNITURE" Sh.p.k ;
- b) kryerja e investimeve dhe financimeve për vitin financier si dhe veprimet apo operacionet e tjera që do tё kérkonin ndryshimin e buxhetit fillestar tё Shoqërisë;
- c) hapja e veprimitarive ose e njësive tё reja, shkrirja ose bashkimi dhe mbyllja tërësisht a pjesërisht e veprimitarive dhe njësive tё Shoqërisë;



- d) blerja, shkëmbimi dhe shitja e pasurive që përbëjnë aktivin e qëndrueshëm të Shoqërisë;
- e) themelimi nga ana e Shoqërisë "IK FURNITURE" Sh.p.k të shoqërive ose pjesëmarrja në shoqëri të tjera të krijuara, ose për t'u krijuar;
- f) marrja e huave afatmesme, afatgjata, dhënia e dorëzanive ose e garancive të tjera, kur këto të fundit tejkalojnë veprimtarinë e zakonshme të Shoqërisë;
- g) përcaktimi i kritereve për diskutimin, përfundimin dhe ndryshimin e kontratës së punësimit me punonjësit;
- h) si dhe ato vendime ose masa që e kapërcejnë veprimtarinë e zakonshme të Shoqërisë dhe që janë të tilla që mund të sjellin ndryshime në objektin e Shoqërisë.

20.5. Administratori mund të delegojë një pjesë të kompetencave të tij, që ai i gjykon të dobishme tek një ose disa persona të tjerë që kryejnë funksione teknike në aktivitetin e Shoqërisë.

20.6. Administratori mund t'u delegojë personave të tjerë ortakë ose jo, disa nga kompetencat e tij për ushtrimin e funksioneve të veçanta. Administratori nuk mund të delegojë tërësinë e kompetencave të tij.

NENI 21 Administrimi i Shoqërisë nga disa Administratorë

21.1. Asambleja e Ortakëve në çdo moment, mund të vendosë që Administrimi i Shoqërisë "IK FURNITURE" Sh.p.k të kryhet nga disa Administratorë.

21.2. Ne kete rast, maredheniet midis administratoreve, kompetencat, te drejtat dhe detyrimet e secilit mund të rregullohen ne rregullore të veçantë ose të parashikohen në vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

21.3. Asambleja e Ortakëve mund te kufizoje kompetencat dhe te drejtat e secilit Administrator dhe/ose te vendose qe ata te ushtrojne kompetencat e tyre me vendime te perbashketa dhe te drejte firme te perbashket ose secili prej Administratorëve të ketë kompetenca të veçanta.

NENI 22 Pergjegjesitë e Administratorit

22.1. Në marrëdhënie me të tretët, Administratori është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë "IK FURNITURE" Sh.p.k

22.2. Çdo ortak joadministrator ka të drejtë dy herë në vit t'i paraqesë me shkrim Administratorit disa pyetje për ato probleme që mendon se përbëjnë shqetësim për veprimtarinë e shoqërisë. Për pyetjet e bëra Administratori është i detyruar t'i përgjigjet me shkrim.

22.3. Shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga veprimet e administrimit të Shoqërisë të kryera nga Administratori edhe kur këto veprime nuk përfshihen në objektin e shoqërisë. Shoqëria "IK FURNITURE" Sh.p.k nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e

dinin që akti i Administratorit e kalonte objektin e Shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë fakt në rrethanat e krijuara.

22.4. Administratori eshte perjegjes individualisht ndaj Shoqerise apo te treteve per:

- a. shkelje të ligjeve;
- b. për shkelje të Statutit, apo
- c. për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

IV. VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMIT

NENI 23 Viti Financiar

24.1. Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor dhe perputhet me vitin kalendarak. Perjashtimisht viti i pare fillon ne diten e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar te Gjykates dhe perfundon ne 31 dhjetor.

NENI 24 Llogarite Vjetore

25.1. Me mbylljen e vitit financiar, administratori i shoqerise ben inventarin dhe llogarite vjetore ne perputhje me legjislacionin mbi kontabilitetin.

25.2. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarine vjetore te shoqerise behet nga Asambleja e Ortakeve brenda nje afati prej 6 muajsh nga dita e mbylljes se vitit financiar.

NENI 25 Fitimi

26.1. Fitimi ose kur eshte rasti humbja e ushtrimit financiar percaktohet nga diferenca midis te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit, ne pajtim me rregullat e parashikuara ne legjislacionin mbi kontabilitetin

26.2. Fitimi i ushtrimit mund te destinohet per te kriuar e plotesuar rezervat e shoqerise ose per t'ju shperndare ortakeve.

26.3. Ne rastin e nje humbjeje Asambleja qe miraton llogarite duhet te vendose per mbulimin e humbjes.

NENI 26 Rezervat

27.1. Rezerva e domosdoshme nuk mund te perdoret as per tju shperndare ortakeve as per shlyerjen apo riblerjen e pjeseve nga shoqeria.

27.2. Ajo perdoret ne rastin e humbjeve kur keto humbje nuk mund te mbulohen (thithen) nga rezerva te tjera.

27.3. Ne rastin kur shoqeria nuk ka te mbartura humbje nga ushtrimet e meparshme masa e fitimeve mbi te cilen llogaritet rezerva e domosdoshme eshte shuma e fitimit te ushtrimit financiar te myllur.

27.4. Ne rastin kur shoqeria ka te mbartura humbje nga ushtrimet e meparshme masa e fitimeve mbi te cilen llogaritet rezerva e domosdoshme eshte shuma e fitimeve te mbetura pas zbritjes se humbjeve te mbartura.

27.5. Heqja nga fitimet per krijimin e rezerves ose per te ushqyer rezerven e domosdoshme eshte te pakten 1/20 e mases se fitimeve. Kjo heqje nuk eshte e detyrueshme kur rezerva e domosdoshme arrin 1/10 e kapitalit themeltar.

NENI 27
Shperndarja e Fitimit

28.1. Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i ushtrimit perkates te cilit:

- a. i zbriten humbjet e mbartura dhe shumat qe hiqen per rezervat
- b. i shtohen fitimet e mbartura.

28.2. Fitimet ndahen ndermjet ortakeve ne perputhje me perqindjen e kapitalit themeltar qe ka secili ortak.

NENI 28
Dividentet

29.1. Asambleja e per gjithshme mund te vendose shperndarjen e dividenteve vetem pasi:

- a. nga njera ane te kete miratuar llogarite vjetore;
- b. nga ana tjeter te kete percaktuar shumen qe do te shperndahet.

NENI 29
Paradheniet per dividentet

30.1. Paradhenie per dividente jane shumat qe u jepen ortakeve perpara miratimit te llogarive vjetore dhe caktimit nga asambleja te dividentit perfundimtar. Keto paradhenie jane te ligjshme, por duke respektuar kerkesat ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe konkretisht me kusht qe :

- a. shoqeria vec rezerves se domosdoshme e kete ne dispozicion rezerva me nje shume te pakten te njejte me paradheniet e shperndara, ose qe nje raport vertetimi i bere nga nje ekspert kontabel i autorizuar te beje fitime neto me te medha se shuma e paradhenieve.
- b. shperndarja e paradhenieve duhet te vendoset nga administratori i cili duhet te caktoje edhe daten e kthimit.

NENI 30
Vendimi per humbjet

31.1. Ne rastin kur rezultati i ushtrimit te myllur eshte humbje, asambleja e per gjithshme mund te vendose:

- a. ose mbartjen e kesaj humbjeje ne ushtrimin e ardhshem, duke kaluar ne nje llogari te vecante "humbje te mbartura"
- b. ose pastrimin e saj nga rezervat, duke perfshire edhe rezerven e domosdoshme.



31.2. Vetem kur humbjet e mbartura te jene pastruar teresisht mund te rifilloje shperndarja e fitimeve.

NENI 31
Detyrimi per te perballuar humbjet

Detyrimi per te perballuar humbjet eshte perpjestimor me kontributet e seicilit ortak.

Cdo marreveshje qe parashikon perjashtimin e nje ortaku nga perballimi i humbjeve eshte i pavlefshem.

Nese shoqeria prishet dhe vihet ne likuidim, atehere likuidatori eshte i detyruar te shlyeje te paret kreditoret e saj.

NENI 32
Publikimi

33.1. Cilido qofte vendimi i marre nga ortaket, prishje apo vazhdimi i shoqerise, ai duhet te publikohet ne nje gazete te autorizuar per publikime ligjore dhe te regjistrohet ne regjistrin tregtar.

NENI 33
Bilanci

34.1. Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 Marsit te vitit pasardhes.

V. PRISHJA E SHOQERISE DHE LIKUIDIMI

NENI 34
Humbja e gjysmes se kapitalit.

35.1. Ne rast se kapitalet e veta te shoqerise per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentet kontabel rezultojne me te uleta se gjysma e kapitalit themeltar, atehere konsultimi i ortakeve eshte i detyrueshem.

35.2. Ortaket duhet te vendosin, mbi mundesine e prishjes se shoqerise brenda 4 muajve nga data e miratimit te llogarive qe pasqyrojne kete humbje. Megjithate edhe konsultimi me shkrim midis ortakeve nuk perjashtohet.

35.3. Vendimi merret ne te njejten menyre si per kryerjen e ndryshimeve ne statut.

NENI 35
Rregullimi i gjendjes

36.1. Neqofte se ortaket kane vendosur ta mbajne shoqerine atehere ata kane nje afat prej nje viti nga data e mbylljes se ushtrimit kur eshte konstatuar gjysma e humbjes se kapitalit per te plotesuar kapitalet e veta.

36.2. Neqoftese plotesimi i kapitaleve te veta nuk arrihet atehere shoqeria duhet te procedoje ne zvogelin e kapitalit ne nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe kane mbetur te pambuluara nga rezervat.



NENI 36
Likuídimi

37.1. Shoqeria prishet me vendim te Asamblese me unanimitet dhe ne perputhje me dispozitat ligjore qe veprojne ne Republiken e Shqiperise.

ORTAKET E SHOQERISE

BEHAR NAZERAJ ISMAILIN KRASHI ILIR KACA

Tanzen Kaceli
Behar Nazeraj  Ismailin Krashi  Ilir Kaca 

N. 1610212021